REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

DREJTORATI I INSPEKCIONIT

Datë :	**01.10.2022**
Referencë	**11-344/10**
Për :	**Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës**
Kopje: **Kopje:**	**Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës** **Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës**
Nga:	**Flamur Sylejmani - Drejtori i Inspekcionit**
Lënda :	**Raporti i muajit-tetor**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit tetor Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendën e planifikuar mujore, pjesë e planifikimit mujor sigurisht që janë bërë ankesat-kërkesat e qytetarëve të cilat shëndrrohen në prioritet në momentin që arrijnë në zyrën tonë në formën e shkruar apo përmes telefonatave.
Kemi vazhduar me organizimin e kujdestarive me objektiv: ndalimin e hedhjes së mbeturinave dhe ndezjen e tyre në deponitë aktive ilegale, shitjen jashtë tregut, problemet lidhur me operatoret-kompanitë e autobusëve dhe probleme të tjera.
Janë realizuar inspektime të vazhdueshme në teritorin komunal, për të pasur nën kontroll ndërtimin që është duke ndodhur me leje ndërtimore dhe për të parandalu ndërtimin pa-leje ndërtimore. Si rezultat i azhuritetit të inspektorëve të ndërtimit, në muajin tetor kemi një vet-rrënim të një objekti pa-leje ndërtimore dhe ndalim të dy objekteve tjera.
Janë realizuar inspektime të vazhdueshme në teritorin komunal, për të parandaluar hudhjen dhe ndezjen e mbeturinave në deponit aktive ilegale. Inspektimet kanë pasur efekt sepse kemi realizuar vërejtje dhe gjoba për ndotësit dhe si rezultat i kësaj kemi arrit që ndezjet në këto deponi të jenë më të rralla. Deponit aktive ilegale të vizituara: kodrën e Kërçevës, Ribar i Madh, Kraishtë, Varigovc, Janjevë, Rubovc, Banullë, Shalë, Magure, Sllovi, Bujan, Topliqan, Torinë.
Gjithashtu inspektorët e trafikut kanë ndjekur agjendën mujore, të cilën e kanë plotësuar me kërkesat-ankesat e qytetarëve. Me prioritet është trajtuar problemi i shitjes jashtë tregut, për të mbajt trotuaret e lira, hapësirat gjelbëruese të pa dëmtuara nga makineritë që shfrytëzohen për ngarkesa, janë realizuar edhe procesverbale, janë realizua edhe gjoba mandatore dhe në vazhdimësi kemi pasur asistencën e policisë. Ankesave të ardhura nga operatorët-kompanitë e autobusëve ju jemi përgjigjur me organizim të pikë kontrolleve. Po ashtu janë realizuar inspektime edhe për taksistët individual të parkingjeve numër 4, numër 5 dhe 3.
Urdhëresa janë bërë edhe për pronarë të bizneseve të cilët kanë penguar banoret e tjerë në objekte banesore duke vendos ventilator në korridoret e përbashkëta. Të cilat urdhëresa janë zbatuar.
Në muajin tetor është organizuar takimi kolegjiumi i drejtorive komunale të inspektoratit, në të cilin takim kemi marrur pjesë. Në këtë takim janë diskutuar tema të shumta lidhur me sfidat e inspektoratit në lokalitete. Kemi diskutuar për ankesat të cilat janë të shumta e që nuk gjejnë përgjegjie nga inspektorati komunal pasi qe tani me janë kompetencë e qendrës, si inspektori i punës dhe ai sanitar. Madje jemi pajtuar bashkërisht të bëjmë një kërkesë për të definuar rolin e inspektorit të tregut.
Është bërë kontroll tek objektet shumë banesore në rrugën “Zylfije Gashi”, në lidhje me zbatimin e kushteve të LMK-së. Investitorëve të cilët kanë përfunduar ndërtimin i është dhënë urdhëresë për një kohë të caktuar që të bëjnë rregullimin e hapësirës gjelbëruese sipas situacionit të ngushtë të projektit dhe të rregullohet vendi për vendosje të kontejnerëve me rrethoj dhe mbuloj. Ndërsa objektet të cilat janë në ndërtim e sipër janë urdhëruar që t’i grumbullojnë

mbeturinat e shpërndara në vend punishte dhe ato ti vendosin në kontejner, të cilin duhet ta kenë në vend punishte deri në përfundim të punimeve.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit tetor janë:

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.
Ndalimi i tregtimit në rrugët e qytetit.
Inspektimi i auto-taksive në qytetin e Lipjanit.
Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.
Kontrollimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet.
Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin "Adem Jashari" në Vrell.
Kontroll për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve të larta.
Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknik	Fletëparaqitje	Vendosje të shiritav zyrtar	Kallëzim penal	Pranim teknike te objekteve me komision	Vërejtje, njoftime	Refuzim për legalizim të objekteve nga DPU-ja	Të hyra nga pranimet teknike	Njoftime për objektet e legalizuara	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygjesore	Gjoba mandatore	Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike	Konfiskim i targave dhe librezës	Menaxhim I tregjeve dhe i kontratave për ndërtim	Aktvendime, ndalesa, urdhëresa, vendime ,shkresa	Inspektim me polici	Asgjësim malli
Biznesi																					
Ambienti	28	9										14			1					4	
Ndërtimi	48	13		2	2		6	7	3			8		2					5		
Trafiku	85	13		2				18				12	1		8		6	6	3	16	
Gjithsej	161	35		4	2		6	25	3			34	1	2	9		6	6	8	20	

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur, po kemi mbajtur takime me pronar të bizneseve dhe me qytetarë në mënyrë individuale.

TAKIME TË TJERA

Kemi marr pjesë në një takim i organizuar nga kolegjiumi i drejtorive komunale të inspektoratit. Takimet kryesisht i kemi mbajtur me qytetarë, pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë.

SFIDAT

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.
Inspektimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore përgjatë zonave urbanistike-ndërtuese dhe parandalimi i tyre duke ndërmarr masa ligjore.
Inspektime të auto-taksive si dhe i firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.
Inspektimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet si dhe mbrojtja e hapësirave gjelbëruese, ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi në çdo lëmi që të njoftojnë Drejtoratin e Inspekcionit, në mënyrë që cilësia në shërbime të jetë në nivel më të mirë të mundshëm.